



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

## GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2022:232987  
Datë: 11.09.2024  
Numri i dokumentit: 06150159

**Ac.nr.7819/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, gjyqtari individual Hysni Bardheci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen përmbartimore të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, me seli në Prishtinë, kundër debitorit B.Gj. nga Mitrovica, rruga "...", nr..., me bazë juridike borxh, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, CP.nr.768/2013 të datës 05.10.2022, me datë 11.09.2024, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**REFUZOHET** e pathemeltë ankesa e kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, CP.nr.768/2013 i datës 05.10.2022, **VËRTETOHET**.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin e atakuar CP.nr.768/2013 të datës 05.10.2022, propozimin për përmbartim të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, me seli në Prishtinë, kundër debitorit B.Gj., lidhur me pagesën e borxhit, e ka konsideruar të tërhequr.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes qenësore të dispozitave të procedurës përmbartuese, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit të aprovoj si të bazuar ankesën e kreditorit, të prish aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë CP.nr.768/13 të datës 05.10.2022, dhe lënda ti kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-faturave 10-12/12, 1-6/13, lidhur me borxhin në vlerë prej 116.60 euro. Gjykata, ka lejuar përmbartimin e kërkuar me aktvendimin përmbartimor CP.nr.768/13 të datës 03.02.2017. Gjykata me konkluzionin CP.nr.768/13 të datës 16.08.2017, ka urdhëruar kreditorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të konkluzionit, gjykatës t'i dorëzoj numrin personal të dokumentit identifikues, me njoftimin se do të konsiderohet se është tërhequr propozimi po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar gjegjësisht pa iu plotësuar propozimi do të hedhet poshtë. Kreditori ka pranuar konkluzionin me datën 31.08.2017, sipas të cilit ka vepruar me datën 07.09.2017, duke sjellë numrin personal të debitorit të urdhëruar sipas konkluzionit.

Duke qenë se numri personal të cilën kreditori ia ka dërguar gjykatës pas verifikimit ka rezultuar së nuk është i debitorit por i një personi tjetër me emrin R.Xh., gjykata e shkallës së parë, përsëri me konkluzionin CP.nr.768/13 të datës 10.06.2022, ka urdhëruar kreditorin që në afat prej 3 ditësh gjykatës t'i dorëzoj numrin personal për debitorin, me njoftimin se konform nenit 99 lidhur me nenin 102 të LPK-së, propozimi për përmbartim do të konsiderohet se është tërhequr po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësia do të hidhet poshtë. Kreditori ka pranuar konkluzionin me datën 23.06.2022, ndërsa ndaj të njëjtit nuk ka vepruar andaj, gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës mungojnë të dhënat për debitorin, konkretisht numri personal i debitorit andaj, me konkluzion CP.nr.768/13 të datës 16.08.2017, ka obliguar kreditorin që në afat prej 7 ditësh gjykatës t'i siguroj numrin personal të debitorit duke e njoftuar për pasojat e mosveprimit konform konkluzionit. Pas përgjigjes në konkluzion nga ana e kreditorit, gjykata verifikoj se numri personal i cekur në përgjigje të konkluzionit është në emër të personit tjetër dhe jo të debitorit dhe se nga kjo situatë e krijuar gjykata përsëri me konkluzion e datës 10.06.2022, ka obliguar kreditorin në sigurimin e numrit personal për debitorin B.Gj., duke e njoftuar se në rast të mosveprimit konform konkluzionit gjykata do të veproj konform nenit 99 në lidhje me nenin 102 paragrafi 3 të LPK-së. Kreditori me datën 23.06.2022, ka pranuar konkluzionin mirëpo nuk ka vepruar sipas asaj që i është kërkuar me konkluzion, duke mos kthyer asnjë konstatim andaj, gjykata duke marr parasysh se kreditori nuk ka vepruar konform konkluzionit të datës 10.06.2022, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit konform nenin 17 të LPP-së, në lidhje me nenin 102, paragrafi 3 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata

e Apelit, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe shkeljeve të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të vlerësohet ligjshmëria e aktvendimit të atakuar.

Gjykata ankimore vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka marrë vendim të drejt kur ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar duke u bazuar në dispozitën e nenit 102, paragrafi 3 të LPK-së, ku përcaktohet se: “ *Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësia po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar...*”, pasi që duke pasur parasysh faktin se gjykata me konkluzionin e datës 10.06.2022, ka urdhëruar kreditorin që në afat prej 3 ditësh gjykatës t’i dorëzoj numrin personal për debitorin me njoftimin lidhur me pasojat në rast të mosveprimit, ndërsa ndaj të njëjtit konkluzion kreditori nuk ka vepruar andaj, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të kreditorit se gjykata e shkallës së parë është dashur që të veprojnë konform dispozitës së nenit 65 dhe 66 të LPP-së, duke e pezulluar procedurën përmbartimore, Gjykata e Apelit vlerëson se këto pretendime janë të pabazuara për faktin se me nenin 65 të LPP-së, janë parë shkaqet se kur mund që të pezullohet procedura përmbartimore dhe se në rastin konkret nuk rezulton se janë përmbushur asnjëra nga këto kushte në atë mënyrë që të bëhet pezullimi i procedurës dhe se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vepruar kur konform nenit 38 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, dhe 99 dhe 102 të LPK-së, ka urdhëruar kreditorin që gjykatës t’i dorëzoj numrin personal për debitorin dhe për shkak të mosveprimit të kreditorit e ka konsideruar të tërhequr propozimin për përmbartim. Pezullimi i procedurës sipas dispozitës së lartcekur do mund të bëhej vetëm në rast se kreditori brenda afatit të caktuar nga gjykata do të arsyetonte pamundësinë e sigurimit të numrit personal të debitorit, ndërsa në rastin konkret kjo nuk ka ndodhur pasi që kreditori nuk është përgjigjur fare në konkluzionin e gjykatës, edhe përkundër faktit se i njëjti ka qenë i njoftua me pasojat ligjore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209 pika b) të LPK-së.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7819/2022, datë 11.09.2024

Gjyqtari,  
Hysni Bardheci